

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrimin të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Qershor, 2023

Reforma në Drejtësi dhe Lufta kundër Korrupsionit, dy eksperiencat shqiptare në Forumin për Dialog, Prespë, 2023

15 - 16.06.2023: Forumi për Dialog, Prespë 2023, në drejtimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut dhe organizatës Miqtë e Evropës (*Friends of Europe*) zhvilloi punimet dy-ditore, me organizimin dhe mbledhjen e shumë paneleve të diskutimit dhe ndarjes së informacionit. Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, mori pjesë në panelin me tematikë: “Mbi çrrënjosjen e korrupsionit përmes politikave të mirëqeverisjes dhe reformës në drejtësi”, ku u ndanë të dhëna dhe u dha eksperiencia e Shqipërisë për rezultatet e Reformës në Drejtësi dhe për politikën qeveritare për të çrrënjosur korrupsionin në administratën publike. Lufta kundër korrupsionit nëpërmjet strukturave të dedikuara dhe të posaçme kundër korrupsionit, promovimi e zgjerimi i shërbimeve elektronike me ofrimin e 1227 shërbimeve elektronike përmes portalit e-albania, reforma në administratën publike për të krijuar një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët, u përmendën nga ministri Manja posaçërisht. Forumi për Dialog i Prespës 2023, ishte një mundësi e vyer për të gjithë pjesëmarrësit për të ndarë përvojat e deritanishme, për të gjetur zgjidhje të reja për probleme të përbashkëta të rajonit e mbi të gjitha për të forcuar qeverisjen e mirë dhe transparencën në vendimarrjen publike. Ministri Manja ndau gjithashtu eksperiencën shqiptare në disa takime bilaterale me Sekretaren e Përgjithshme të OSCE znj. Schmid, të dërguarin e posaçëm të Gjermanisë në Ballkan, z. Sarrazin dhe Sekretaren e Përgjithshme të UNDP, znj. Živković, me të cilët u rikonfirmua vijueshmëria e projekteve të përbashkëta në drejtësi dhe luftën kundër korrupsionit.




Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe ANAC, një mundësi bashkëpunimi më shumë kundër korrupsionit

16.06.2023: Struktura antikorrupsion në nivel ekzekutiv në Shqipëri (Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit) dhe Agjencia Kombëtare Italiane kundër Korrupsionit – ANAC, bëhen gati për të nisur një bashkëpunim institucional dypalësh. Ministri i Drejtësisë njëherazi Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, Ulsi Manja, zhvilloi një takim bilateral pune me Drejtorin e Përgjithshëm të ANAC, Giuseppe Busia, në Tiranë. Të dy drejtuesit e lartë, diskutuan mbi bashkërendimin e instrumenteve efektive për parandalimin e korrupsionit dhe ndëshkimin e tij. Edukimi ligjor për mekanizmat antikorrupsion, shtrirja e mjeteve të ndëshkimit administrativ, forcimi i kapaciteteve të profesionistëve të ligjit për hartimin e politikave eficiente kundër korrupsionit, forcimi i kapaciteteve teknike dhe rritja e kualiteteve administrative, komunikim dhe ndërgjegjësim i shtuar kundër korrupsionit si edhe për një ndëshkim eficient dhe të dobishëm kundër korrupsionit ishin tema të bisedës. Shumë shpejt mes Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit dhe ANAC do të marrë jetë një marrëveshje mirëkuptimi dhe bashkëpunimi që do të formalizojë intensifikimin e bashkëpunimit dhe lehtësojë krijimin e një kulture kundër korrupsionit. Eksperiencia italiane e luftës kundër korrupsionit është një model i preferuar nga Shqipëria, duke konsoliduar vendosjen e një agjence multidisiplinore në të ardhmen e afërt në vend, ku parandalimi – ndërgjegjësimi – ndëshkimi të jenë bashkë.



Nën-komitete të Komisionit Evropian dhe Shqipëria zhvillojnë takimet për kuadrin ligjor dhe strukturat e administratës

14, 15, e 27.06.2023: Procesi i integritit evropian dhe seancat e raportimit të strukturave teknike të administratës së lartë dhe të mesme së vendit kanë vijuar me takimet e zhvilluara gjatë tre ditëve të muajit qershor, për informacionet e Kapitullit 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore. Në tre ditë, struktura të administratës shqiptare, të fushës së drejtësisë dhe të luftës kundër korrupsionit, nën drejtimin e Zëvendësministrit të Drejtësisë Adea Pirdeni me përfaqësues të Komisionit Evropian, raportuan për zhvillimet e kuadrin ligjor, institucional, rregullator, aktivitetin në praktikë dhe planifikimet e së ardhmes për këto dy fusha. Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion përgatiti dhe ndau informacione të detajuara mbi arritjet e fushës në të treja qasjet e luftës ndaj korrupsionit: parandalim – ndëshkim – ndërgjegjësim. Takimi i 14-të i Nënkomitetit "Drejtësi, Liri dhe Siguri" (14 e 15 qershor 2023) dhe i PAR SG (27 qershor 2023) evidentuan përpjekjet e detajuara të integritetit dhe transparencës, masat e marra për parandalimin dhe reduktimin efektiv të korrupsionit veçanërisht në sektorët me rrezik të lartë, financimin e partive politike, kapacitetet e institucioneve përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit si dhe zbatimin e rekomandimeve të GRECO-s. Takimet janë në kuadrin e takimeve të planifikuara të Komisionit Evropian me Shqipërinë dhe të qartësimit të ecurisë së vendit drejt standardeve ligjore dhe organizative të Bashkimit Evropian.




Shqipëria pjesë e panelit nj-ditor të UNCAC për parandalimin e korrupsionit

14 - 16.06.2023: Shqipëria u zgjodh një ndër tre shtetet pjesëmarrëse në panelin “Ndërlidhja midis qasjes parandaluese dhe ndëshkuese kundër korrupsionit”, së bashku me Austrinë dhe Ekuadorin. Punimet e javës plenare të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit - UNCAC, një aktivitet global i rëndësishëm vjetor, pjesë e të cilit u bë seanca e këtij paneli e solli Shqipërinë në vëmendjen dhe interesin për të njohur dhe informuar mbi zhvillimet tona jo vetëm rreth parandalimit të korrupsionit, por edhe prezantimit të strukturave antikorrupsion dhe zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit. Kompetenca dhe mandati i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit si një autoritet kombëtar me funksione në fushën e parandalimit, ndërgjegjësimit dhe ndëshkimit të korrupsionit u prezantuan nga Drejtori i Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion, Rovena Pregja. Paneli pati një kohëzgjatje një-ditore dhe pyetje e diskutime nga pothuaj gjithë vendet pjesëmarrëse në seancë. Ndërkombëtarizimi i përpjekjeve kundër korrupsionit të Shqipërisë, ndërveprimi dhe shkëmbimi i përvojave me vendet tjera në këtë kontekst, ndihmojnë në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar kundër korrupsionit për të pasur rezultate të qëndrueshme. Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion është struktura kompetence dhe përfaqësuese zyrtare e Shqipërisë në organizmat teknike e profesionalë të fushës, e cila ndërvepron dhe shkëmben informacione dhe të dhëna dhe garanton zbatimin e politikave qeveritare.

Raporti i monitorimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion, janar-mars 2023, i aksesueshëm nga publiku

20.06.2023: Grupi Tematik Antikorrupsion në nivel teknik, i përbërë nga përfaqësues të të gjithë institucioneve të përfshira në zbatimin e Planit të Veprimit Antikorrupsion, zhvilloi takimin teknik të punës, në të cilin dakordësoi përmbajtjen e raportit të monitorimit janar - mars 2023, i cili përkon edhe me vitin e fundit të zbatimit të SNKK 2015 - 2023. Draft-raporti i monitorimit paraqet në mënyrë analitike dhe sasore progresin e bërë nga të gjitha institucionet raportuese për zbatimin e masave dhe aktivitetëve të SNKK, të planifikuara për zbatim për këtë periudhë, nivelin e realizimit të objektivëve strategjikë mbështetur në këtë analizë si edhe ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin e kaluar të monitorimit. Në këtë 3-mujor të parë 2023, zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit është në masën 63.24%. Përkatësisht sipas qasjeve, progresi është: parandalimi 84.69%; ndëshkimi 50.87% dhe ndërgjegjësimi 54.16%. Për t'u evidentuar janë rezultatet pozitive që lidhen me transparencën në veprimtarinë shtetërore, përmirësimin e aksesit të qytetarëve në informacion, forcimin e integritetit të nëpunësve publikë, vijimi i përpunimit të statistikave si dhe aktivitetet ndërgjegjësuëse dhe edukuese të publikut mbi pasojat e korrupsionit. Ky raport monitorimi dëshmon gjithashtu konsolidimin e rezultateve të qasjes ndëshkuese të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion, Policisë së Shtetit dhe organeve që ushtrojnë ndjekjen penale.

Draftin final të monitorimit mund të aksesohet në link: <https://www.drejtesia.gov.al/raporte-monitorimi-2023/>



Drejtorja e Përgjithshme Antikorrupsion bën analizën ndëshkimore në 6 muajt e vitit 2023

01 - 30.06.2023: Drejtorja e Përgjithshme Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë ka shtuar të dhënat e luftës korrupsionit në nivel administrativ. vazhdon të angazhohet në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri, përmes rezultateve konkrete. Për 6-mujorin e parë, janar- qershor 2023, janë 39 raporte përfundimtare përmes të cilave janë propozuar 96 masa për fillimin e ecursisë disiplinore për nëpunës të administratës publike, 30 masa për largim nga detyra dhe 118 rekomandime. Nga hetimet e thelluara administrative, janë proceduar gjithsej 9 referime pranë organeve që ushtrojnë ndjekjen penale për 28 personash të kallëzuar penalisht. Tipologjia e rasteve të gjetura në shkelje të dyshuara për korrupsion janë veprimtaria e nëpunësve Agjencia Shtetërore të Kadastrës, duke përfshirë edhe drejtoritë vendore të saj, Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Agjencia Kombëtare e Ushqimit, strukturat e shërbimit shëndetësor, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Drejtorja e Përgjithshme Antikorrupsion bashkëpunon ngushtë me Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion për të siguruar transparencë dhe integritet në institucionet publike.

Denonconi raste dhe praktika abuzive në: koordinatoriak@drejtesia.gov.al

UNODC bën bashkë institucioneve audituese dhe organeve antikorrupsion

31.05 – 02.06.2023: Zyrtarë të nivelit të lartë të Ministrisë së Drejtësisë morën pjesë në seminarin rajonal të organizuar nga UNODC, për bashkëpunimin e agjencive antikorrupsion dhe autoriteteve të kontrollit të financave publike në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Duke mbajtur parasysh që korrupsioni është një fenomen kompleks, që prek sektorë të ndryshëm të shoqërisë dhe paraqet një kërcënim serioz për zhvillimin ekonomik të vendit, bashkëpunimi midis agjencive kombëtare antikorrupsion dhe autoriteteve përkatëse që kontrollojnë përdorimin e buxhetit të shtetit siç përmenden Kontrollat e Larta të Shtetit, paraqet një rëndësi të shtuar. Në këtë takim, pala shqiptare u përfaqësua nga Sekretari i Përgjithshëm Ismail Shehu dhe Drejtori i Përgjithshëm i Antikorrupsionit Florin Demollari, të cilët prezantuan autoritetet përkatëse në nivel kombëtar, mandatin, juridiksionin dhe nivelet e bashkëpunimit mes tyre. Më tej u diskutua rreth ngjashmërive dhe efektivitetit të mandateve, mënyrave ekzistuese të bashkëpunimit dhe sfidat që ata kanë. Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit - UNCAC, e cila përmban dispozita të detyrueshme për shtetet palë, ofron një kuadër të gjerë për parandalimin e korrupsionit, duke kërkuar dhe rekomanduar shtetet palë të zbatojnë një gamë të gjerë masash, nga politikat kundër korrupsionit, integriteti në sektorin publik, deklaratat e pasurive dhe rregullat për konfliktin e interesave, prokurimi publik, menaxhimi i financave publike, deri te roli i sektorit privat dhe shoqëria civile. Ky seminar u organizua në formën e sesioneve plenare përgjatë disa ditëve, duke u mundësuar pjesëmarrësve të jepnin ide, të prezantonin dhe të zhvillonin diskutime me synimin për të shkëmbyer informacione dhe për të shtjelluar më tej konceptet e trajtuara. Ky aktivitet bëri bashkë përfaqësues nga 8 vende të Evropës Juglindore, si Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania dhe Serbia.




Rajoni i Ballkanit rrit vëmendjen mbi qëndrueshmërinë ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit tek të rinjtë dhe të miturit

06 - 07.06.2023: Ministria e Drejtësisë merr pjesë në aktivitetin e zhvilluar në Shkup, Maqedoni e Veriut me fokus forcimin e rezistencës ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit të të rinjve në Evropën Juglindore. Ky takim dy-ditor, i organizuar nga Kryesia e OSBE-së në Maqedonisë së Veriut dhe Iniciativa Globale Kundër Kriminalitetit Transnacional (GI-TOC), bashkoi autoritete qeveritare nga organet ligjzbatuese, gjyqësori, institucionet arsimore dhe praktikantët e luftës kundër korrupsionit, academia, shoqëria civile dhe rinia, nga pesë shtete: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Kjo përpjekje rajonale synoi angazhimin e aktorëve të përfshirë në parandalimin efektiv të krimit të të miturve dhe në forcimin e rezistencës ndaj tij, duke kontribuar njëherazi në mirëqeverisje dhe sundimin e ligjit, duke mbajtur në konsideratë rrezikun e shtuar të të miturve që rekrutohen nga grupet kriminale dhe përfshihen në veprimtari të paligjshme. Aktiviteti synoi gjithashtu të kontribuonte drejt lehtësimit të platformave rajonale për dialog dhe bashkëpunim mes aktorëve kyç për të shkëmbyer praktikat e mira, përvojat dhe mësimet të nxjerra nga parandalimi i krimit të të miturve dhe edukimi i tyre mbi ligjshmërinë dhe integritetin, si dhe për të identifikuar kapacitetet, mangësitë dhe sfidat. Sigurimi që të rinjtë të kenë një marrëdhënie më të mirë me drejtësinë, kërkon që të përmirësohet monitorimi dhe raportimi i rasteve të identifikuar dhe të ketë një vlerësim efektiv mbi ndikimin e masave të ndërmarra ndaj të miturve në konflikt me ligjin.

Konferencë rajonale autoritete publike – OSHC për sinjalizimin

13.06.2023: Drejtorja e Përgjithshme Antikorrupsion mori pjesë në konferencën e organizuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes në kuadër të Koalicionit të vendeve të Evropës Juglindore për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Në kuadër të aktivitetëve dhe agjendës për përafrimin e legjisllacionit, politikave dhe rregulloreve të sinjalizuesve me standardet më të avancuara ndërkombëtare, Koalicioni po promovon përafrimin e Direktivës së BE-së për sinjalizimin përmes kërimit, monitorimit dhe advokimit. Me këtë qëllim, kjo konferencë bëri bashkë përfaqësues nga vendet e Ballkanit Perëndimor që punojnë në organet publike, si dhe aktorë të tjerë të interesuar në këtë proces. Në konferencë Ministria e Drejtësisë dhe ILDKPKI në cilësinë e institucionit drejtues për instrumentin e sinjalizimit përditësuan pjesëmarrësit mbi zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve në Shqipëri dhe dhanë disa rezultate konkrete të zbatimit të tij: ILDKPKI ka zgjeruar kompetencat që nga viti 2016 për të monitoruar zbatimin e ligjit për sinjalizuesit, 208 masa administrative janë dhënë për organet që nuk kanë respektuar ligjin e 30 raste denoncimi, nga të cilat, 2 në sektorin privat. Shqipëria pritet të përafrtojë kuadrin ligjor të sinjalizuesve brenda vitit 2025. Të gjitha vendet e rajonit po shqyrtojnë përafrimin e ligjeve për sinjalizimin me Direktivën e BE-së, për të krijuar një kornizë ligjore të plotë si dhe për të arritur rezultate bindëse sa i takon zbatimit të ligjit për sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.



Staf i Ministrisë së Drejtësisë merr pjesë në Shkollën e Integritetit, të organizuar nga *Transparency International*



26- 30.06.2023: Më shumë se 50 përfaqësues nga vende të ndryshme morën pjesë në Shkollën e 14-të të Integritetit, e cila u organizua në Vilnius, Lituani, nga *Transparency International*. Pjesëmarrës ishte edhe një specialist i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, Marko Cenaj. Kurrikula ishte mbështetur tek diskutimet dhe seminarët në tema të ndryshme si transparencja, integriteti publik, sjelljet korruptive, korrupsioni në sport dhe korrupsioni në sektorin e mbrojtjes. Kjo platformë u shfrytëzua për të ndarë përvoja, njohuri dhe praktika më të mira midis vendeve, me synimin për të pajisur individët me mjetet dhe njohuritë e nevojshme për të luftuar korrupsionin dhe për të promovuar transparencën në vendet e tyre. Pjesëmarrësit në Shkollën e Integritetit i përkisnin profileve të organizatave jo-qeveritare dhe nga sektori publik. Përmes këtij forumi, ata kishin mundësinë për të ndarë përvojat e tyre në lidhje me transparencën, integritetin publik dhe luftën kundër korrupsionit në kontekstin e tyre kombëtar. Shkolla e Integritetit u përqendrua gjithashtu në tërheqjen e vëmendjes drejt sfidave të korrupsionit dhe ndërtimit të një rrjeti të fortë bashkëpunimi. Pjesëmarrja e përfaqësuesve nga vende të ndryshme krijoi një platformë shkëmbimin e praktikave më të mira dhe strategjive të suksesshme për të luftuar korrupsionin.



Dy vjet e-buletini mujor antikorrupsioni

30.06.2023: Ministria e Drejtësisë mbush dy vjet që prej numrit të parë të e-buletinit: Antikorrupsioni. Një mjet komunikimi informues, ndërgjegjësues dhe vizibël i aktivitetit në fushën e luftës kundër korrupsionit ka shënuar plot numrin e 25-të të publikimit. Buletini elektronik mujor i Ministrisë së Drejtësisë erdhi si një iniciativë e stafit të politikave antikorrupsion për të dhënë një pasqyrë të hollësishme të veprimtarive kryesore të fushës, duke përfshirë informacione të rëndësishme të mbledhura në një periudhë mbi baza mujore. E-buletini ka filluar të hartohet qershorin e vitit 2021, si i pari e-buletin i ministrisë, një iniciativë që u replikua në vijim edhe nga të tjera struktura të institucionit, duke kaluar dy vite të suksesshme. E-buletini ofron një mundësi të çmuar për qytetarët, institucionet, organizatat e shoqërisë civile dhe të gjithë aktorët e interesuar, për të qenë të informuar, të përfshihen në përpjekjet për të luftuar korrupsionin dhe promovimin e transparencës në drejtësi. Në çdo numër të e-buletinit është përfshirë informacion i detajuar mbi aktivitetet kryesore të zhvilluara gjatë 30 ditëve kalendarike. Ky informacion përfshin ndër të tjera, progresin e arritur në zbatimin e politikave efektive në qasjen parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuere. Me ndihmën e këtij mekanizmi të informimit publik, Ministria e Drejtësisë synon të rrisë vetëdijen publike rreth përpjekjeve dhe progresit të arritur në fushën antikorrupsion. E-buletini mujor i Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion është një raport periodik i Ministrisë së Drejtësisë në ushtrimin e detyrave të saj si Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit.



Mund të lexoni të gjithë numrat e e-buletin në të dy gjuhët, shqip dhe anglisht në link-un: <https://drejtesia.gov.al/e-buletin/>

